

SEE New Perspectives (Perspektivat e reja të Evropës Juglindore) Kursi i nivelit të lartë për fotografë profesionistë nga Evropa Juglindore.

Mirë se vini në këtë faqe interneti për fotografë profesionistë nga Evropa Juglindore, që dëshirojnë të regjistrohen dhe të paraqesin aplikimin e tyre për kursin e nivelit të lartë "SEE New Perspectives", organizuar nga Fondacioni World Press Photo në partneritet me Robert Bosch Stiftung.

Afati i fundit për regjistrimin në internet është ditën e hënë, 24 maj 2010.

Afati i fundit për dërgimin e aplikimit në internet është ditën e hënë, 31 maj 2010.

Kursi i nivelit të lartë "SEE New Perspectives" është një iniciativë e World Press Photo dhe Fondacionit Robert Bosch Stiftung. Ai do të zhvillohet në periudhën mes korrikut dhe dhjetorit 2010.

Imazhet e Ballkanit në vitet '90 kanë ndikuar ndjeshëm në formimin e perceptimeve të rajonit në të gjithë botën, si dhe brenda rajonit. Kursi synon të sfidojë këndvështrimet ekzistuese dhe të inkurajojë fotografët të eksplorojnë perspektivat e reja të rajonit.

Kursi i nivelit të lartë "SEE New Perspectives" ka si objekt 15 fotografë profesionistë nga nëntë vendet e mëposhtme në Evropën Juglindore: Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Rumani dhe Serbi.

Kursi synon t'i japë shtysë zhvillimit tuaj profesional dhe të forcojë aftësitë tuaja në prezantimin e historive. Nëse jeni të interesuar të merrni pjesë në këtë kurs dhe plotësoni kriteret e aplikimit, ju mund të aplikoni përmes kësaj faqeje interneti.

Kursi i nivelit të lartë "SEE New Perspectives" do të ndahet në tri faza të ndryshme:

1. Kursi i nivelit të lartë

Nëse përzgjidheni si pjesëmarrës, ju do të ftoheni të merrni pjesë në një kurs të nivelit të lartë në Berlin, Gjermani, në periudhën 1-8 shtator 2010. Gjatë këtij kursi, ju do të mësoni nga tre fotografë të shquar ndërkombëtarë, redaktorë dhe kuratorë fotografish. Kursi do të përfshijë ushtrime praktike, vlerësime të portofoleve personale, prezantime interaktive nga tutorët dhe trajnime për shërbimet në internet që do të përdoren pas kursit. Përmbajtja dhe programi i saktë i kursit do të përcaktohen pas përzgjedhjes dhe do të varen edhe nga nevojat mësimore të paraqitura nga pjesëmarrësit. Gjithashtu, gjatë kursit ju do të punoni dhe do të diskutoni mbi propozimin tuaj për detyrën të cilën ju do të duhet ta përfundoni në periudhën nga mesi i shtatorit deri në fund të nëntorit 2010.

2. Detyra

Pas kursit, të gjithë pjesëmarrësve do t'u kërkohet të krijojnë një histori me fotografi për një temë të caktuar. Juve do t'ju kërkohet ta krijoni këtë histori jashtë vendit tuaj, por brenda rajonit të Evropës Juglindore. Për të realizuar këtë detyrë, ju do të merrni një grant.

Gjatë krijimit të historisë me fotografi, ju do të këshilloheni nga drejtuesit e kursit përmes një sistemi mësimor në internet. Trajnuesit do të vlerësojnë progresin tuaj, do të bëjnë sugjerime për hapat e mëtejshëm dhe do t'ju këshillojë për montazhin përfundimtar.

3. Seminari përfundimtar

Rezultatet e detyrës suaj do t'u paraqiten pjesëmarrësve të tjerë dhe trajnuesve dhe diskutohen mes tyre në një seminar përfundimtar treditor në fillim të dhjetorit 2010 në Berlin, Gjermani.

Në të njëjtën kohë me seminarin përfundimtar në Berlin, dhjetë redaktorë të fotografisë nga mediat e Evropës Juglindore do të ftohen të marrin pjesë në një seminar pesëditor mbi leximin vizual në Berlin, Gjermani.

Kush mund të aplikojë?

Kursi i nivelit të lartë është i hapur për 15 fotografë profesionistë me kombësi dhe banim në një nga vendet e mëposhtme brenda Evropës Juglindore: Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Rumani ose Serbi.

Gjithashtu, duhet të punoni si fotograf profesionist në fushën e foto-gazetarisë dhe (ose) fotografisë dokumentare. Profesionist do të nënkuptojë një prej kriterëve të mëposhtme ose një ndërthurje e tyre:

- Që keni një kartë gazetari dhe (ose),
- Që puna juaj është botuar rregullisht në gazeta, revista lokale ose ndërkombëtare, ose botime në internet gjatë vitit të fundit dhe (ose),
- Që puna juaj është ekspozuar ose është botuar në një libër gjatë katër viteve të mëparshme.

Përveç kësaj, ju duhet të keni minimalisht 2 dhe maksimalisht 15 vite përvojë pune profesionale dhe të zotëroni të paktën nivelin mesatar të gjuhës së folur dhe të shkruar angleze.

Si të aplikoni?

Nëse dëshironi të regjistroheni për këtë projekt, duhet të ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Klikoni në Register (Regjistrohu) në faqen e aplikimit në internet,
- Lexoni dhe shqyrtoni me kujdes Terms and Conditions (Kushtet e Përgjithshme) që duhet të pranoni në qoftë se dëshironi të vazhdoni me regjistrimin,
- Plotësoni formularin e regjistrimit për të kërkuar një emër përdoruesi dhe një fjalëkalim,
- World Press Photo do të kontrollojë të dhënat tuaja profesionale,
- Nëse aplikimi juaj miratohet, ju do t'ju jepet një emër përdoruesi dhe një fjalëkalim me email,
- Ju mund të hyni në këtë faqe interneti duke përdorur emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin,
- Kontrolloni të dhënat tuaja personale dhe profesionale për të siguruar që nuk keni bërë ndonjë gabim gjatë regjistrimit,
- Ngarkoni dy skanime të punëve të botuara në 12 muajt e kaluar (nga muaji prill 2009 deri në prill 2010),
- Ngarkoni CV-në tuaj të përditësuar,
- Shënoni vendin e fundit të punës,
- Shënoni arsyen për të marrë pjesë në kursin "SEE New Perspectives",
- Shënoni nevojat tuaja mësimore,
- Shënoni dy ide për histori për projektin tuaj,
- Ngarkoni dhe redaktoni shembuj të punës suaj (10-20 imazhe të veçanta, si dhe një histori e përbërë nga 5-12 imazhe).

Mos u nxitoni për të përfunduar aplikimin tuaj. Nëse dilni nga sesioni, informacionet e fundit që keni ngarkuar do të ruhen dhe ju mund të ktheheni më vonë për të plotësuar aplikimin tuaj. Vetëm pasi të keni përfunduar të gjithë hapat e mësipërm dhe të jeni të bindur për aplikimin tuaj, klikoni Submit (Dërgo). Pasi aplikimi juaj të dërgohet zyrtarisht, ju nuk do të mund ta ndryshoni më përsëri.

Afati i fundit për të regjistruar dhe për të marrë një emër përdoruesi dhe fjalëkalim është dita e hënë, 24 maj 2010.

Afati i fundit për të dorëzuar aplikimin tuaj është ditën e hënë, 31 maj 2010.

Pas datës 31 maj 2010, një komision ndërkombëtar, profesionist dhe i pavarur do të përzgjedhë 15 pjesëmarrësit bazuar në cilësinë e punëve të paraqitura. Për të siguruar paanshmërinë, përzgjedhja do të kryhet në mënyrë anonime, pra anëtarët e komisionit nuk do të dinë emrat e personave, punët e të cilëve do të vlerësojnë.

Në 30 qershor 2010 rezultatet e përzgjedhjes do t'ju dërgohen me email.

Mbi organizatorët

Fondacioni World Press Photo

World Press Photo është një organizatë e pavarur, jofitimprurëse me qendër në Amsterdam, Holandë, vend ku kjo organizatë u krijua në vitin 1955. Zyra në Amsterdam vepron qendra e një rrjeti me profesionistë në mbarë botën, dhe është pikërisht ky rrjet që bën të mundur organizimin e konkursit, ekspozitave dhe aktiviteteve të tjera në një shkallë kaq të madhe.

Së pari dhe më kryesorja, World Press Photo njihet për organizimin e konkursit vjetor më të madh dhe më prestigjioz në botë të fotografisë gazetareske. Fotografitë fituese të çmimit mblidhen në një ekspozitë lëvizëse që vizitohet nga më shumë se dy milion njerëz në 45 vende të botës. Çdo vit publikohet një vjetar ku paraqiten të gjitha aplikimet fituese në gjashtë gjuhë.

World Press Photo është gjithashtu mjaft i interesuar në nxitjen e zhvillimeve në foto-gazetari dhe inkurajimin e ndarjes së njohurive, duke organizuar kështu Kursin e nivelit të lartë Joop Swart, si dhe seminare, trajnime dhe projekte të tjera edukative në të gjithë botën. Të gjitha këto aktivitete janë në përputhje me misionin e organizatës për të promovuar në mbarë botën standardet më të larta në foto-gazetari dhe për të nxitur mirëkuptimin ndërkombëtar përmes këtyre mjeteve të informacionit.

Organizata financohet me mbështetjen e gjerë të sponsorëve të saj kryesorë institucionalë, si dhe me sponsorimin e projekteve dhe subvencionet për aktivitete individuale.

World Press Photo mbështetet nga Dutch Postcode Lottery dhe sponsorizohet nga Canon dhe TNT në të gjithë botën.



Për më shumë informacione rreth World Press Photo dhe programeve të saj edukative, ju lutemi vizitoni: www.worldpressphoto.org

Robert Bosch Stiftung

Robert Bosch Stiftung është një nga fondacionet kryesore gjermane të lidhura me një kompani private. Ai zotëron 92 për qind të aksioneve të Robert Bosch GmbH.

I krijuar në vitin 1964, ai përfaqëson përpjekjet filantropike të Robert Bosch (1861-1942), duke u përqendruar në fushat e shkencës, shëndetësisë, marrëdhëniet ndërkombëtare, arsimit, shoqërisë dhe kulturës.

Në Shtuttgart fondacioni drejton Robert-Bosch-Krankenhaus (Spitali Robert Bosch), Institutin Dr. Margarete Fischer Bosch për Farmakologji Klinike, si dhe Institutin për Historinë e Mjekësisë.

Nga viti 1964 deri në 2008 fondacioni ka vënë në dispozicion rreth 900 milion euro për projekte. Në vitin 2008 janë shpenzuar rreth 60 milion euro për financimin e projekteve.

Fondacioni Robert Bosch Stiftung ka qenë aktiv në Ballkan që nga fillimi i viteve '90-të. Fondacioni inicioi Komisionin Ndërkombëtar mbi Ballkanin në vitin 2003, në bashkëpunim me Fondacionin King Baudouin, Fondin Marshall për Gjermaninë nga Shtetet e Bashkuara dhe Fondacionin Charles Stewart Mott. Bazuar në përfundimet e Komisionit dhe si vazhdim direkt i rekomandimeve të tij kryesore, në vitin 2005 u krijua zona e fokusit "Evropa Juglindore". Përveç kësaj, u themelua Fondi Evropian për Ballkanin në bashkëpunim me fondacione evropiane për të ndërmarrë dhe mbështetur nisma që synojnë afrimin e Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian. Gjithashtu, fokusi i aktiviteteve të Robert Bosch Stiftung në rajon vendoset te gazetarët dhe po ashtu ofron mbështetje për iniciativat që rrisin mirëkuptimin reciprok dhe përmirësojnë harmonizimin. Janë zgjeruar gjithashtu edhe disa programe të përzgjedhura ekzistuese në fusha të tjera programatike për të përfshirë në to edhe Evropën Juglindore.

Për më shumë informacione rreth fondacionit Robert Bosch Stiftung, ju lutemi vizitoni:

www.bosch-stiftung.de

WORLD PRESS PHOTO

Robert Bosch **Stiftung**